

LESIKU DHE TEMATIKAT E PËRDITSHME TË VAJZAVE TË REJA TË NDIKUARA NGA GLOBALIZMI

Edona JAHU¹

¹PhD cand. – Asistente në Fakulteti i Filologjisë, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”

Përmbledhje

Ky punim paraqet pasqyrë të leksikut të vajzave adoleshente dhe tipareve të tij, saktësisht do të shihen emrat, mbiemrat dhe foljet, duke dhënë shembuj dhe interpretime të efekteve që emetojnë fjalë të huaja, dhe disa të tjera që janë të pazakonshme në “gjuhën e vajzave” që njihet si “viktimizeuese”, e pabarabartë me gjininë tjetër. Do të vihet theksi te tematikat për të cilat flitet në këto komunikime spontane, e që vërehet ndikim i globalizmit apo i kontaktit me ngjarjet me renome botërore që janë të qasshme falë transmetimit dhe përhapjes së shpejtë të informatave nga secili cep i botës. Në këtë moshë, fjalori mendor i përditshëm i tyre pasurohet vullshëm qoftë me fjalë shqipe që s’i kanë përdorur më parë: *thashetheme, zyrë etj.*, të huaja, si pasojë e globalizmit: *my love, dear, okay, like, merci.* (sidomos të anglishtes, për shkak të trysnisë në rrjete sociale dhe si një “*lingua franca*”), madje të krijuara prej tyre për nevoja të një “leksiku të fshehtë”. Janë incizuar 33 biseda të rastësishme të vajzave 17-18-vjeçare nga Prishtina dhe janë nxjerrë fjalët që janë nevojitur për studim. Të dhënat tregojnë se vajzat kanë përparuar në pasurim të leksikut edhe me fjalë që njihen si “tipike të djemve” si të sharat (edhe në anglishte), megjithatë më ‘të lehta’ se të gjinisë tjetër, emrat: *idiot, budalla*, ose mbiemrat me ngjyrim keqësues si: *i tmerrshëm, katastrofal*. Kjo, nisur nga mendimi konvencional se janë të paguximshme për t’u shprehur. Kompetenca leksikore e respondenteve e dëshmon të kundërtën. Tematikat e bisedave ndërlidhen me personazhet e njohura, larmishmëri lajmesh të absorbuara nga rrjetet sociale e platforma me shtrirje globale. Ky materializim i përbashkimit të informacionit mbarëbotëror te secili individ flet për konvergencën globale në rrafsh të mundësisë së interaksionit me njerëz për të njëjtat tema e me të njëjtën shkallë njohurie.

Fjalët çelës: *leksiku mendor, vajza adoleshente, globalizmi, kompetencë leksikore, emrat, mbiemrat, foljet.*

Abstract

This paper presents an overview of the lexicon of teenage girls and its features, precisely, nouns, adjectives and verbs will be analysed, also through giving interpretations of the effects that emit foreign words, and some others that are unusual in the "girl's language" which is known as "victimizing" or unequal to the other gender. Emphasis will be placed on the topics discussed in these spontaneous communications, and the global impact of renowned events that are accessible to everyone, transmitted with the rapid spread of information from every corner of the world. At this age, their daily mental vocabulary is rapidly enriched with Albanian words that they did not use before e.g. gossip, doctor, etc., foreign words, as a consequence of globalism as: my love, dear, okay, like, merci (especially of English, due to its impact in social networks and as a "lingua franca"), also for the need of a "secret lexicon". 33 random conversations of 17-18-year-old girls from Prishtina were recorded. The data shows that girls have progressed in enriching their lexicon, even with words that are known as "typical of boys" such as swear words, however "softer" than those of the other gender, nouns: idiot, stupid, or adjectives with a pejorative connotation such as: terrible, catastrophic. This, based on the conventional opinion that they are impossible to recognize. The lexical competence of the respondents proves the opposite. The topics of conversation are related to famous personalities, the variety of news absorbed by social networks and platforms with global reach. This materialization of worldwide information shows the global convergence of interaction with people and possibility to touch different topics and with others.

1. Hyrje

Kur studiohet gjuha, si njësi e parë e kuptimshme¹³² që i bie në sy studiuesit është fjala, qoftë ajo si mjet shërbyes për lidhje gramatikore (parafjalët, lidhëzat etj.) apo me kuptim të mëvetësishëm (fjalë përmbajtjesore: emrat, mbiemrat, foljet, ndajfoljet, përemrat). Kurse, për kategorizim, së pari vëmendja është tërhequr nga këto të dytat, kur Dionis Trakas në vitin 100 p.K. ka dalluar emrat që lakohen në rase dhe foljet që zgjedhohen në kohë dhe në vetë. Mbiemrat janë klasifikuar në një grup me foljet, e pastaj si nënklasë e emrave¹³³. E më vonë janë dalluar ndajfoljet, pjesëzat, lidhëzat, parafjalët.

Çdo fjalë ruhet në memorie me përfaqësimin e caktuar fonologjik si dhe me kuptimin i cili lidhet me të, që edhe është arsyeja pse vihet në përdorim fjala, përndryshe nuk do të konsiderohej e tillë. Për t'i përmbledhur fjalët e një gjuhe bashkë me kuptimet e tyre, hartohen fjalorët nga leksikografët, nxitur nga një besim apo pajtim i përbashkët shoqëror për denotacionin e konotacionin që përçojnë fjalët. Aty rregullohen sipas ligjesh të brendshme dhe specifike fono-morfologjike të një gjuhe. Megjithatë, as ata s'arrijnë ta përfaqësojnë në mënyrë ideale vëllimin kuptimor të çdo fjale, që edhe po të mundnin, ai pëson ndryshime në kohë, sepse udhëhiqet nga folësit.

Pasi që të rritet kontakti me shoqërinë, botën e jashtme, të rinjtë fillojnë ta pasurojnë leksikun edhe me fjalë që s'i përkasin shqipes apo i krijojnë ato brenda saj, në bazë të modeleve fjalëformuese që gjenerojnë vazhdimisht fjalë të reja. Kjo është interesante, sidomos te gjinia femërore, e cila për shumë kohë s'ka pasur mundësi për liri shprehjeje¹³⁴, e aq më pak eksperimentim gjuhësor e përdorim fjalësh të huaja. Qasja në internet ka ndikuar në shkëputjen e jetesës nën hijen e sjelljeve gjuhësore më tradicionale. Kjo, duke parë gra e vajza ndërkombëtarisht të njohura për veprimtarinë e tyre jashtë kornizave të vëna padrejtësisht gjatë së kaluarës.

Ndikimi i globalizmit është vërejtur në pasurimin e bujshëm të fjalorit mendor me fjalë të huaja si dhe neologjizma. Prandaj, në këtë punim, për ta krijuar idenë e këtij trualli të përbashkët botëror, fillimisht do të jepen shpjegime bazë rreth nocionit që është si hije dhe shkas kryesor për vrullin e hovin zhvillimor të pozicioneve më parë të kundërshtuara si: barazia ndërgjinore në çdo fushë, liria për ta shfrytëzuar gjuhën sipas nevojave personale e grupore, përhapja enorme e anglishtes pa krijuar kufizime paraprakisht etj. Ai është globalizmi. Ndërsa e shohim relevant edhe shpjegimin e natyrës së fjalës si shenjë gjuhësore asimetrike, e cila e jep mundësinë për zgjerim repertori. Më pas, do të kalohet te pjesa hulumtuese e punimit. Megjithëse një numër fjalësh të analizuar nuk janë huazime të drejtpërdrejta nga anglishtja apo gjuhë të tjera, ato janë nxjerrë në pah si reflektuese të progresit e lirisë gjuhësore të vajzave, qoftë në aspektin e temave apo në dimensionin e zhvillimit të pandërprerë të leksikut. Studimi ka dëshmuar se përhapja e teknologjisë, lidhja mes pjesësh të ndryshme të botës ka ndikim (in)direkt në formësimin e leksikut mendor.

¹³² Edhe pse morfema cilësohet si njësi më e vogël e kuptimshme, përgjithësisht ajo s'ka kuptim të mëvetësishëm ndaras nga rrënja leksikore.

¹³³ John LYONS, *Introduction to Theoretical Linguistics*. London: Cambridge University Press, 1968.

¹³⁴ Deborah Tannen *Gender and Discourse* Oxford:Oxford University Press, 1996.

Qëllimi i studimit

Synimi i punimit, përmbledhur në disa pika, është:

- Të paraqitet dhe analizohet leksiku i vajzave, fokusuar në tri kategori gramatikore: emra, mbiemra, folje, duke u ndalur më tepër te fjalët e huaja, neologjizmat dhe fjalë të pazakonshme aktive në repertorin e tyre.
- Të evidentohen për nga ana kuantitative kategoritë gramatikore të pranishme në bisedat e analizuara, të ilustrohen me shembuj edhe sipas nënlojeve të tyre, për kah ana semantike e sintaksore, dhe domethënia e tendenca që është e ndërlidhur me zgjedhjen për përdorim të njërit variant kundrejt tjetrit i cili është sinonimik apo me barasvlerë semantike me të.
- Të bëhet definimi i tematikave që shtjellohen gjatë bisedave, bazuar te leksiku mbizotërues dhe vija e përgjithshme semantike dhe kohezive e tekstit të folur. Po ashtu, jepen edhe arsyetimet

Korpusi dhe metodologjia

Korpusi është siguruar me anë të incizimit të bisedave spontane në ambient shkolle ose kafeneje nga vetë respondentët ose me praninë e studiueses. U është kërkuar që gjatë bisedave të mos diskutojnë shumë për çështje personale, por për tema më të përgjithshme, në mënyrë që të dalin në pah ndikimet (in)direkte të globalizmit te vetë bisedat. Fjalët sipas kategorive gramatikore që paraqiten në këtë punim, do të shkruhen fillimisht në trajtën përfaqësuese të tyre në formën dialektore ashtu siç janë thënë, e më pas jepen veçoritë më tipike të kategorive gramatikore dhe semantike. Gjithashtu, emrat të cilët me konversion kanë kaluar në mbiemra për shkak të funksionit përcaktor p.sh. *Ish trim* janë trajtuar si të tillë, sepse japin cilësi apo vlerësim subjektiv të dikujt. Nëpërmjet paraqitjes së këtyre rezultateve, dëshmohet njëkohësisht roli që e ka luajtur përhapja e kuptimit të frazave si “mendimi i lirë”, “feminizmi”, “të shprehurit lirshëm” etj.

Pjesa teorike

2. Ndikimi i globalizmit në diskurs

Globalizmi është term që përfshin një sfond të gjerë fushash, qoftë kulturore, shkencore e informuese, të cilat rritin konvergencën, bashkëpunimin e integrimin mes njerëzve. Pra, më vete përmban çështje komplekse, për ç’arsye vijnë përpyekjet për ta gjetur përkufizimin adekuat e të plotë për të. Globalizmi përgjithësisht u referohet “vlerave, ideve dhe besimeve të atyre që duan ta promovojnë integritetin ekonomik, politik e kulturor të njerëzimit”¹³⁵. Pra, është përhapje e praktikave, vlerave si dhe e teknologjisë¹³⁶. Ndër të tjera, ai arrin të sjellë fjalë, koncepte si dhe mënyra të reja të përdorimit gjuhësor, duke qenë se të gjitha fenomenet aktive e gjejnë shprehjen e tyre brenda repertorit gjuhësor.

¹³⁵ Richard Harris. Introduction: Globalization and Globalism in Latin America: Contending Perspectives. *Latin American Perspectives*, 29(6), 2002, 5-23, f.7.

¹³⁶ Martin Albrow. *The Golden Age: State and Society Beyond Modernity*. Stanford, CA: Stanford University Press, 2000.

Shumica e autorëve e shohin globalizmin si term të ri e modern, që përfshin proceset, lidhjet, opinionet publike dhe pushtetet e forcat dominuese që zhvillohen e mbizotërojnë rreth tërë botës. Ata pretendojnë se zhvillimet ekonomike e bashkëkohore sjellin përfitim për një botë të përparuar e demokratike¹³⁷. Balancimi ndërgjinor (në pjesëmarrje, gjuhë e fusha të tjera) përbën një nga çështjet me të cilat është e preokupuar shoqëria në botë, e veçanërisht gratë, statusi i të cilave është mohuar ndër shekuj në shoqëri, duke u krijuar imazh më inferior në kundërvënie me burrat. Përmes globalizmit, është përhapur botërisht edhe fryma e barazisë gjinore. Feminizmi si mënyrë e këndvështrimit të të gjitha qenieve njerëzore si të barabarta e me të drejta qasjeje në çdo fushë, është e vetmja armë që ekziston për t'i trajtuar çrregullimet ekonomike, ekologjike e shoqërore të shkaktuara nga globalizimi i shfrenuar. Pra, feminizmi, si një lëvizje tjetër sociale¹³⁸ është ndër fenomenet që e nxit mbrojtjen e barazisë gjinore edhe në aspektin ekonomik, politik, shoqëror, lirinë gjuhësore në përgjithësi, dhe si frymë është përhapur nga procesi i globalizmit.

2.1 Fjala – “shenjë asimetrike”

Fjalët e një gjuhe të gjallë janë në lëvizje të pandërprerë për nga struktura, e cila është më rezistuese ndaj ndryshimeve dhe për nga elementet semantike, të cilat me kohë i shtyjnë në skaj elementet e vjetra dhe formojnë struktura kuptimore të reja. Së pari lind një përbërës i ri brenda të njëjtit kuptim, pastaj një nuancë, në shkallë të tretë lind kuptimi i ri leksikor, në të katërtën formohet një bllok i ri kuptimesh, pra zgjerohet përmbajtja leksikore, e në të pestën shpërbëhet polisemia, lindin homonimet – ky është diferencimi maksimal semantik¹³⁹.

Polisemike është fjala që pasurohet me shumë kuptime, por përsëri lidhja e tyre është mjaftueshëm e fortë sa të qëndrojnë brenda një njësie leksikore – e kur shkëputen kalojnë në *homonime*. Gjuhëtarët, prejardhjes semantike i kanë bërë analizë të ngjashme me fjalëformimin për nga struktura p.sh. *vrapim* vjen nga *vrapoj* me prapashtesën *-im*. Në analogji me këtë analizë, te kuptimet hulumtohet nga kanë rrjedhur ato p.sh. *Tërë jetën duhet të lëvizësh përpara* –ku folja *lëviz* merr kuptimin *përparoj*, *zhvilloj aftësitë*– e i cili parimisht vjen nga kuptimi: *e shpie diçka a dikë nga vendi ku është në një vend tjetër*¹⁴⁰.

Edhe pse te fjalëformimi studiuesi ndeshet me vështirësi, sepse s'është gjithmonë e mundur të dallohen tema, rrënja e fjalës etj., megjithatë, krahasuar me analizën fjalëformuese, te prejardhja semantike hasen më shumë sfida gjatë ndarjes së strukturës semantike. Së njëjtës fjalë, kur i “tendoset” kuptimi dhe ai fillon të shkëputet, krijohen dy njësi të veçanta leksikore me formë të njëjtë, por me kuptim krejtësisht të ndryshëm: *bankë-bankë*. Një ndër mënyrat e formimit të homonimisë është edhe polisemia – kur njëri kuptim abstraktohet aq shumë, sa që shkëputet nga fjala dhe krijohet njësi tjetër leksikore. Ndërsa te sinonimia dhe antonimia fjalët dallohen tërësisht nga forma, por ka një nyjë semantike që i lidh fjalët, pra ruajnë një lidhje të përbashkët, tek e para kuptim të ngjashëm, tek e dyta të kundërt. Pra, shenja gjuhësore është asimetrike dhe e luhatshme nga folësit.

¹³⁷ Florian Coulmas. Changing language regimes in globalizing environments. International Journal of the Sociology of Language 175/176, 3-15, 2005.

¹³⁸ Peter Waterman, 2002 *Reflections on the 2nd World Social Forum in Porto Alegre: What's Left Internationally?* Working Papers Series, no 362, The Hague: Institute of Social Studies.

¹³⁹ Më gjerësisht, shih Jani Thomai, *Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe*, Botimet EDFA, 2009 dhe Jani Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, SHBLU, Tiranë, 1999.

¹⁴⁰ <http://www.fjalorshqip.com/>

Shenjë është gjithçka që sjell ndërmend diçka tjetër. “Gjuha është vetëm një ndër sistemet semiotike”¹⁴¹. Meqë fjalët ekzistojnë si të tilla vetëm pse shenjojnë diçka, atëherë edhe ato përbëjnë shenja. Kështu, me emërtimin e fjalëve si shenja, semiotika i zgjeron mjaft kompetencat shkencore. Sosyri¹⁴² propozon modelin dyanësh të shenjës gjuhësore, ku *shenjuesi* paraqet formën që merr shenja, ndërsa i shënuari konceptin që përfaqëson. Marrëdhënia mes tyre është arbitrare, sepse s’varet nga atributet e objektit pse quhet ashtu p.sh. s’ka ndonjë arsye pse ulëses i thuhet *karrige*. Lidhja mes tyre është edhe mjaft komplekse, sepse siç thamë, gjuha ka aftësi për zhvillim dhe ndryshon pa ndërprerë.

Sipas mëvetësisë kuptimore dhe rolit që kryejnë, ka fjalë funksionale si: lidhëzat, pjesëzat, parafjalët, dhe përmbajtjesore: emrat, mbiemrat, foljet, ndajfoljet. Prej këtyre, do të komentohet përdorimi nga vajzat e reja prishtinase i tri kategorive (emra, mbiemra, folje), si fjalë që shprehin koncepte dhe mjaft produktive sa u përket kombinimeve me parashtesa, parashtesa etj.

3. “Gjuha e vajzave”

Cuellar¹⁴³ shtron pyetjen nëse ekziston një “gjuhë ekskluzivisht e vajzave”, emërtim të cilin mund ta merrnim si sinekdokë, sepse s’diskutohet për një sistem të veçantë, por tipare gjuhësore tipike që u mvishen vetëm vajzave. Ka pasur raste të krijimit të një gjuhe fiktive veç për vajza, si rasti i hulumtueses së gjuhësisë eksperimentale, Suzzete Elgin¹⁴⁴, ose p.sh. japonezët dallojnë pjesëza dhe pasthirra të dedikuara vetëm për gra. Por, në pjesën dërmuese të gjuhëve, veç pse kanë të preferuara ndërtime leksikore ose të përdorura në respektim të konventave të ngulitura për to, s’do të thotë se e gjithë ajo zakonshmëri gjuhësore është e tyre, si e shkëputur.

Ndër shekuj, gratë janë sfiduar mjaft në çdo aspekt, por sot, me përjashtime, askush s’i ndalon me këmbëngulësi të patejkalueshme që të hedhin hapa të rinj. Ato mund të krijojnë repertorë të vet leksikorë e sintaksorë dhe të rritin vetëdijesimin për të drejtat që u takojnë. Deborah Tannen me të drejtë potencon se “s’mund të thuhet se burim i pafuqisë së vajzave janë strategjitë linguistike si: jodrejtëpërdrejtshmëria, heshtja apo pyetjet, madje ato mund të kenë qëllim të kundërt”¹⁴⁵. Pra, jo gjithçka që konsiderohet tipike e vajzave është shenjë inferioriteti.

Pabarazinë sociale, të reflektuar në atë gjuhësore, e para që e ka dëshmuar shkencërisht me studim faktik është Robin Lakoff¹⁴⁶. Ajo e portretizon pabarazinë e vajzave në shoqëri dhe paraqet disa veçori gjuhësore të tyre duke elaboruar hipotezën se *vajzat s’bëjnë pyetje, s’janë të ashpra, kanë gramatikë të mbikorrektuar, janë më të pasigurta* etj. Sipas Crawfordit¹⁴⁷, krejt këto dallime janë produkte sociale dhe kulturore. Por, insistimi i tyre në dy dekadat e fundit ka shkaktuar një lëvizje përpara në liri shprehjeje.

¹⁴¹ Ferdinand de Saussure, *Kursi i Gjuhësisë së Përgjithshme*, Përkthyer nga Rexhep Ismajli. Prishtinë: Rilindja, Redaksia e Botimeve, 1977, f.50.

¹⁴² Ferdinand de Saussure. *Course in General Linguistics*. Duckworth, London, 1983.

¹⁴³ Sergio Bolaños Cuéllar *Women's language: a struggle to overcome inequality*, “Form and Function” (Issue 19), University of Columbia, 2006 f.149.

¹⁴⁴ Suzzete Elgin (1936-2015) në novelën e saj të vitit 1984 “*Native Tongue*” ka provuar të ndërtojë një gjuhë të grave për qëllime praktike, ku ka përmbledhur me një fjalë koncepte të jetës së përditshme p.sh. Eeme- dashuria për dikë që s’e respekton, Lolaad- ndjenja të brendshme etj

¹⁴⁵ Deborah Tannen, *Gender and Discourse* Oxford: Oxford University Press, 1996, f.27.

¹⁴⁶ Robin Lakoff *Language and Woman's Place: Language in Society*, Vol. 2, No. 1: Cambridge University Press, 1973 f. 45-80.

¹⁴⁷ Mary Crawford, *Talking Difference on Gender and Language*, London: Sage Publications, 1995.

Rezultatet e studimit

4. Veçori të përgjithshme të emrave në korpus

Emri përbën emërtimin e një sendi, dukurie, veprimi, vendi, ndjenje ose ideje. Ai mund të kryejë shumë funksione: kryefjalë, rrethanor, përcaktor etj. Kjo kategori është mjaft aktive në fjalorin e përditshëm të vajzave, që është dëshmuar edhe në studim. Janë evidentuar 155 emra në korpusin e zgjedhur, të cilët janë analizuar nga pikëpamja gramatikore e semantike.

Fillimisht po përmendim emrat në gjuhën shqipe më dendurisht të përmendur dhe e sqarojmë zgjerimin e fushës semantike të tyre gjatë përdorimit: *Shpi, banesë, shkollë, fakultet, shesh, oborr, klasë*. Në emërtimin e gjësendeve janë kujdesur që t'i përfshijnë ata që lidhen me përditshmërinë e tyre.

Si *shpi* i referohen gjithnjë vendit ku jetojnë, pavarësisht nëse ajo është si ndërtim banesë: pra, si kuptim në kontekst thjesht përmban vendin ku jetojnë. Forma tipike të emrave të përmendur konkretisht janë: *Po shkoj nshpi, ko mu regjistru nfakulltet, s'di a ke kom najkon nbanesë*. Pra, funksionalisht këta emra janë futur në diskursin e vajzave si rrethanorë vendi, në shumicën e rasteve të paraprirë me parafjalën *në*. Pastaj, *takohum te sheshi*, si një vend i njohur për to, *t'pres n'klasë* etj.

a. Gjësende: *telefon, çantë, shminka, top, libër, fletore, laps, shnollë*, veshje: *fustan, bluzë, fund*.

Emri *telefon* është përmendur rreth 12 herë, që e bën këtë emër më të përhapurin. Kjo tregon rolin e telefonit në përditshmëri, jo vetëm për të komunikuar, por edhe për dëgjim muzike, lojëra etj. Si shembuj të fjalive: *shminkat m'u kan' tha, kryt n'libër don me m'hi, ama qat fletore*.

b. Emra abstraktë: prejfoljorë: *e dalme, e folme*, të tjerë: *dashnia, shoqni, sinqeritet, pushim, ide, menim, termin*.

Të tjerë: *vëlla(u), motër, tezake, kusherin*,

c. Emrat me funksion thirrori: *idiot, budalla, majmunk, qur*, të cilët thuhën me ngjyresa humori.

E gjithë kjo gamë e kësaj kategorie tregon se të rejat janë të prira të kenë të pranishëm koncepte a të referuar në diskursin e tyre, e rrjedhimisht, e pasurojnë këtë pjesë ligjërata leksikisht dhe semantikisht.

4.1 Thirrorët në anglishte

Rezultat karakteristik i punimit është mënyra se si i drejtohen njëra-tjetrës ose personave për të cilët flasin, e cila është përgjithësisht e lidhur me fjalë përkëdhelëse të gjuhës angleze, fushë ku vërehet bindshëm lidhja e zgjedhjeve leksikore me internetin e filmat, programet që rëndom i përmbajnë këta thirrorë.




Fig.1. Numri i thirrorëve sipas gjuhës.

26 nga numri i përgjithshëm i thirrurëve janë në anglishte, e 13 në shqipe, që do të thotë se ka mbizotërim të anglishtes edhe te kjo gjymtyrë. Ato preferojnë që t'i referohen njëra-tjetrës, siç thonë, ashtu siç i dëgjojnë nëpër filmat/serialet e preferuara të tyre dhe për këtë arsye, gjejnë përdorim më të gjerë. Nga kjo shkallë e lartë, ndër më të përdorurit nga të rinjtë janë: *sweetie, honey, sweetheart, tomboy, my sweetpie, my soulmate, my masterpiece, my darling, my cupcake* etj – fjalë të cilat janë përvetësuar nga ekspozimi ndaj kësaj gjuhe, kryesisht përmes internetit e programeve të shumta që ofrohen rreth botës.

Lakoffi¹⁴⁸ bën krahasim me mënyrën si bëjnë vërejtje vajzat me thirrurin: *Oh e dashur e paske prishur*, me djemtë të cilët përdorin të shara. Por, te ky studim vajzat s'kanë hezituuar t'u drejtohen djemve vrazhdë: p.sh. gjatë incizimit të bisedave, kur ata u kanë penguar me zhurmë, ato kanë reaguar me: *o budall mos m'pengo, idiot mshela*. Kjo ka shërbyer si fakt për ndryshimet që po ndodhin ndaj dekadave dhe se me vendosmëri, mund të ndryshojnë edhe praktikat gjuhësore. Emër interesant i përdorur është *majmunk* që nuk përdoret me denotacion, por si ngacmim për shoqen. I shtohet edhe prapashtesa –k që nuk është në gjuhën standarde, por vetëm në të folur, kur u adresohet vajzave.

4.2 Përndarja e emrave konkretë e abstraktë

Sa i përket ndarjes sipas perceptimit shqisor, si emra konkretë janë konceptet që mund të preken, shihen, shijohen, ndihen. Ndërsa emrat abstraktë përfshijnë ide, emocione, ose ndjenja që edhe pse nuk shihen, ekzistojnë dhe janë të pranishëm në të folur. Distribucioni i tyre në punim është ky:




Fig.2. Shfaqja e emrave sipas (mos)perceptimit shqisor.

Nga gjithsej 155 emra, 50.3% e tyre janë konkretë, 26.4% abstraktë, 23.2% janë në kategorinë “të tjerë”, ku janë futur emrat e lëndës të, familjarëve të cilët gjejnë përndarje edhe në gjuhën angleze: *tomël/milk (qumësht) lang, juice (lëng fruti), motra(sister), babi, llaku* etj. Pra, një pjesë e mirë e korpusit përbëhet nga përmendja e gjërave konkrete, qoftë të pranishme gjatë bisedës ose thjesht objekt diskutimi.

¹⁴⁸ Robin Lakoff *Language and Woman's Place: Language in Society*, Vol. 2, No. 1: Cambridge University Press, 1973 f. 45-80.

Në korpus janë vërejtur emra të domeneve të ndryshme kuptimore, kryesisht të përditshmërisë, mësimi, aktiviteteve shkollore, veshje etj. Ky përgjithësim i tematikave është bërë me anë të kolokimit, që është “tendencë e fjalëve të ruajnë lidhje leksikore me njëra-tjetrën¹⁴⁹, p.sh. ku është fjala *lëndim* ka gjasë të jetë edhe *dhimbje*, pastaj *nxënës-mësim*, *thikë-pirun* etj. – kanë një nyjë kuptimore që i lidh. Ndërsa në materialin tonë, janë shembujt: *fakultet-profesor*, *dashni-sinqeritet*, *libër-fletore*, *fustan-fund*, *shmink-karmin*, *shkollë-klasë*, *motër-vëlla* etj.

5. Mbiemrat

Mbiemri tregon cilësinë ose vlerësimin që i bëhet dikujt, një sendi a dukurie të caktuar. Si kategori gramatikore, ata mund të klasifikohen sipas aspektit konfiguracional – ku fokus është rendi ose pozicioni strukturor në fjali (para ose pas emrit, foljes etj.), funksional (si çka shërben në fjali), komplementar (kë e plotëson) dhe semantik (kuptimet tipike që përçon. Huddelston¹⁵⁰ dallon: funksionin predikativ, atributiv, postnominal, inflektiv. Ky i fundit nuk vlen në shqip, sepse mbiemrat nuk e ndryshojnë formën gjatë lakimit në shoqëri të emrave as gjatë shkallëzimit si në anglishte (ang. big-bigger, shq. i madh - më i madh). Ata mund të jenë pjesë e kallëzuesit emëror (predikativ) *Është fëmijë i ëmbël*, ose përcaktorë të emrit, (postnominal) *Një fustan i kuq*, e gjithashtu mund të vendosen para emrit i *dashuri djalë* (atributiv). Gjithashtu mund të modifikohen nga ndajfoljet e sasisë: *tepër e madhe*, *shumë e mirë*.

Si mbiemra të vërejtur me origjinë nga anglishtja janë: *shum wierd*, *so loving*, *so dangerous*, *so disgusting nice*, *big*, *small*,

E mbiemrat cilësorë shqip të pranishëm shpesh në korpus: *E omël*, *e dashne*, *e mirë*, *e lezetshme*, *katastrofal*, *e tmerrushme*, *e keqe*, *e trishtushme*, *i gjatë*, *i vogël*, *e lazdrume*, *e rancishme* të panyjshëm: *pun'tore*, *pedante*, *trime*.

Më poshtë është paraqitur përndarja në bazë të kriterit semantik: cilësorë dhe marrëdhëniore:




Fig.3. Përndarja kuantitative e mbiemrave sipas kriterit semantik

¹⁴⁹ Michael Halliday, Yallop Colin. *Lexicology: A Short Introduction*. London: Continuum, 2007. f.15.

¹⁵⁰ Rodney Huddleston., 1984. *Introduction to the grammar of English*. Cambridge: Cambridge University Press, f.299.

Denduria në shkallë të lartë e cilësorëve shpreh konotacionin se ato janë të prira që të përqafojnë leksema më ekspresive të qëndrimit të tyre personal, e që tipikë shprehës për kah përmbajtja semantike që bartin janë mbiemrat cilësorë, të cilët shoqëruar edhe me ndajfolje sasië: *tepër, shumë* i mbivlerësojnë konceptet, dukuritë etj. Këto shprehi janë krijuar edhe me bindjet kulturore e të rrënjosura se vajzat e kanë të përbashkët shfaqjen më të hapur të ndjenjave, e pjesërisht nga natyra e personalitetit të tyre. Disa nga to janë nga brumi i shqipes, e disa nga anglishtja.

5.1 Karakteristika fjalëformimi te mbiemrat

Vajzat pra shprehin haptas qëndrimet e tyre subjektive për njerëz, objekte etj. Prej prapashtesave, vërehen –al që është e huazuar, -shme, ueshëm-, ndërsa –ume është variant dialektor i prapashtesës trajtëformuese të pjesores -uar (khs. e punuar – e pun-ume).

Kur përdoret mbiemri i *gjatë* te *pushim i gjatë* është fjala për kohën më të madhe që përfshihet në pushim, e jo si tipar i dukshëm. Po ashtu, *e omël* si shprehje për tiparin e butësisë. Pra, “vajzat priren të përdorin fjalë “shumëngjyrëshe” dhe mbiemrat si: *e dashur, e ëmbël*, që rrallë përdoren nga djemtë”¹⁵¹. Përdorimi i mbiemrave cilësorë tregon për vëmendjen që u kushtojnë vajzat karakteristikave të gjësendeve, njerëzve etj.

Mbiemrat me funksion thirrori: *oj e dashur, oj e bukur, oj e harrushme*

Të tjerë: *e pa-marrne-vesh, e budallme, e puçrraft, e hallakattë, e fshime, e lujt, e trentë, e hjeshe, e hasë, e llafeve*

Për shkak të nevojës për ta cilësuar dikë që nuk kupton asgjë, meqë mbiemri i normuar në shqipe *e pakuptueshme* nuk rrok nuancat që mëtohen të shprehen, vajzat përngjitin njësinë marr vesh (*e pa-marrnevesh*) – që edhe pse shkruhet ndaras funksionon si njësi e vetme dhe e pandashme. Kësaj strukture ato ia shtojnë parashtesën fjalëformuese –pa dhe nyjën femërore *e*. Ngjashëm edhe *e budallme*, prej emrit budalla+nyjë+ prapashtesa *me*. Ndërsa te mbiemri *e fshime* – mendohet trushpëlarë, që s’mendon në mënyrë racionale. Nga folja *hallakat* (me kuptimin: shpërndaj andej e këtej një grumbull a një tufë), me nyjë e prapashtesë e nxjerrin kuptimin *si njeri që sillet e vepron si i/e lënë nga trutë*. Kuptim të ngjashëm ka edhe *e trentë*, dhe *e lujt*. Kjo e fundit vjen nga shprehja *luaj mendsh*, që më pas është modeluar si mbiemër. *E hasë* është fjalë dialektore me emëzimin e foljes *ha*, vendosjen e saj në gjinore, pastaj shndërrimin e saj si mbiemër kuptimisht. Krejt këto pra e kanë nga një rrënjë dhe me anë të njohjes së mundësive fjalëformuese të shqipes, natyrshëm e ushqejnë leksikon, çka e gjykojmë si krijimtari të pranueshme. Çdo gjuhë i ka burimet për ta zgjeruar leksikon¹⁵². Dhe kjo s’do të thotë se ai zgjerohet me fjalë të huaja, por me burimet fjalëformuese, që në shoqëri me fjalë të ndryshme zhvillojnë kuptime që në rrjedhë kohore modifikohen ose ndryshojnë krejtësisht.

Në teorinë e Chomskyt (Government-Binding theory, 1981)¹⁵³, mbiemrat përshkruhen si +N dhe +V d.m.th. ndajnë veti të emrave dhe foljeve. Në fakt ngjashmëri mjaft të dukshme kanë me ndajfoljet, ku shumë prej mbiemrave kanë korrespondueset ndajfolje: *e mirë – mirë, e bukur – bukur, e gjatë – gjatë e lehtë – lehtë etj.*

¹⁵¹ Sri Wahyuningsih, *Men and women differences in using language: a case study of students at Stain kudu*. EduLite Journal of English Education Literature and Culture 3(1):79, 2018, f.79.

¹⁵² Michael Halliday, Yallop Colin. *Lexicology: A Short Introduction*. London: Continuum, 2007, f.100.

¹⁵³ Noam Chomsky. *Lectures on government and binding*. Dordrecht: Foris, 1981.

Në vlerësime ka pasur raste të kallëzuesve emërorë të kryefjalës të shprehur me emër, të prejardhur me konversion emër-mbiemër sipas mënyrës së fjalëformimit: *ish trim ish bullic, ish princesh*. Edhe këta janë futur në klasë të mbiemrave në këtë punim, sepse arsyeja e përdorimit të tyre në bisedë është *cilësimi*, e që është funksion i mbiemrit: Sipas pozicionit, që zënë në fjali mbiemrat kanë këtë distribucion në korpus:




Fig.4. Pozicioni i mbiemrit në bisedat e incizuara

Vajzat më së shumti preferojnë t’i vendosin mbiemrat pas foljeve, si plotësues të tyre, ku këto të fundit komplementohen me ta, duke treguar ndonjë cilësi të kryefjalës ose kundrinorit. Preferojnë ta theksojnë atributin e dikujt në një fjali, e jo emrin+atributin+përcaktor tjetër p.sh. preferojnë të thonë *Djali është i mirë*, më tepër sesa *djali i mirë është...* (*pas emrit*) ose *djali është shumë i mirë* (*pas ndajfoljes*). Por, nuk mungojnë as këto dy të fundit. Po ashtu, mbiemri që është gjendur pas emrit, e që vetë është kallëzues emëror, është parë me funksion predikativ, për shkak se i referohet subjektit dhe mund të qëndrojë edhe pa emrin të cilin e përcakton: *Ai është profesor i vështirë – ai është i vështirë*.

6. Foljet

Folja tregon veprimin që ndodh në të tashmen, që ka ndodhur në të shkuarën apo që do të ndodhë në të ardhmen. Përbën gjymtyrën kryesore në fjali, ku në fjali të përbëra ose në rastet ku shërbejnë si gjymtyrë homogjene, mund të ketë dy ose më shumë folje: *unë shkova dhe kreuva punë*. Por, më shpesh në këtë studim fjalitë kanë qenë të thjeshta, me vetëm një folje, çka është veçori e ligjërimit të folur.

Globalizmi ka futur një numër foljesh ose grupe foljore me prejardhje nga anglishtja: *updatej, llovi, ta boj add, e akceptova, e hejtirat, e zumirat, hejterat*.

6.1 Veçori të përgjithshme të përhapjes

a) Foljet më të përhapura në trajtën përfaqësuese janë: *thom, ha, rreh, rri, shkoj, bëj, udhëtoj, thirri n’telefon, t’shkruj, dal*.

b) Njësia *thirri ntelefon* është marrë si e vetme, sepse i përgjigjet foljes telefonoj. Te përdorimi *tshkruj s’e* ka këtu kuptimin që është në fjalor: *paraqit tingujt e ligjërimit a ngulit fjalët me anë shenjash të posaçme grafike* apo *shënoj a shpreh një mendim ose diçka tjetër me shkrim; hartoj*

*një vepër letrare*¹⁵⁴, por e ka: *do të dërgoj mesazh*. Pra, kjo fjalë është zgjeruar kuptimisht. Po ashtu, edhe *dal* te *hajt se dalim sonte kan 9*, s' do të thotë thjesht shkuarje nga një vend i mbyllur jashtë, por *do të argëtohem për qejf*. Të tjera: *trejnirat, kcej (vallëzoj), harxhoj, maju*

c) *Maju (mbaju)* te *maju oj çikë* – jo për të shtrënguar diçka as për ta pasur mbi vete, por te vajzat e incizuara do të thotë: *mos fol, mos pubiko gjithçka*. Interesante është folja *kcej (kërcej)* ka përdorim të gjerë në kuptimin *vallëzoj, hedh valle*. Lidhje kuptimore ka për shkak të lëvizjes fizike, semë që i përbashkon këto fjalë, por nuk dihet saktësisht pse ky zëvendësim bëhet në shumicën e rasteve në gjuhën e folur.

Sa i përket referencës kohore, vajzat janë të prira të përdorin foljet në kohët e shkuara në variantet dialektore: *kish mar, ki thon, thojshë, ka shku, kish udhëtu*, por edhe të ardhmen me paskajoren geqe: *ko me msu, ko me thirr, ko me dal* etj. *Harxhoj shum'* në sensin *shpenzoj para*. Ky ndërtim edhe pa kundrinën *para* nënkuptohet se është fjala për të holla. Sa i përket potencialit për të pranuar kundrinë, foljet ndahen në: kalimtare dhe jokalmimtare. Në korpus këto dy lloje kanë pasur këtë përndarje:




Fig. 5. Shfaqja e foljeve sipas (mos)pranimit të kundrinës.

61% e foljeve kanë qenë kalimtare *marr, jap, harxhoj, ha, publikoj, vnoj, pi*, ndërsa 39% jokalmimtare: *kcej, flej,, rri, rreh, shkoj*. E kjo lidhet edhe me konstatimin e lartpërmendur se vajzat përmendin më shumë emrat konkretë, me çka zakonisht pasprihen foljet kalimtare: *marr para, ha bukë*. Folja *vnoj* është variant dialektor i *vendos* që siç e shohim, ka pasur tendencë që të përshtatet me foljet e zgjedhimit të parë me *-j*. Interesant është edhe *rreh* (rrah) që është hasur rreth 5 herë, e që tregon lirinë për të “kërcënuar”, ndonëse me shaka.

7. Tematikat e ndikuara nga globalizmi

U sqarua se respondentet kanë biseduar me njëra-tjetrën lidhur me temat jashtë jetës së tyre personale, siç u është kërkuar. Pikërisht kjo shmangie e ka spikatur mundësinë që të gjejnë muhabet në çështje që i marrin si të garantuara se njihen nga bashkëbiseduesja, duke e marrë

¹⁵⁴ <http://www.fjalorshqip.com/>

parasysh qasjen e të gjithëve në informacion përmes portalesh, ëeb-faqesh të njohura botërore e vendore.

Këto janë temat kryesore aktive gjatë bisedave që mundësohen si pasojë e globalizmit:

- Këngëtarët e famshme: *Rita Ora ish martu me at plakun, Britni Spearsi ish shku nëmëndin, çka mpëlqeu qysh ish vesh Angelina, a e pa Oscarin, Selena Gomez ish bo edhe aktore moj, khu e shkreta Shakira me atë burrë ia mur ftyrën, me tradhtu para krejtve plus me fmi, Rihanna hala s'e ka qit ftyrën e djalit,*

- Ngjarjet politike apo të shënuara botërisht: *Mbretnesha kish dek mas 70 vjete nfron, Bidenit i kish ra përkrahja, shum e tutshme lufta në Ukrainë, jon rrit kto organizimet për gjininë femërore, Rusia nuk kthehet temas e Serbia kundër neve ma shtir e ka pas, s'po di a ka faj Albini a, qito sulmet jon shpeshthu o Allah met sulu nmes trrugës*

- Sëmundjet e ndryshme: *po kom lexu që kanceri i lkurës po t'u bojke prej solariumit, e kom lexu që diabeti ma shum lidhet me gjene, nbaz tportaleve duhani s'osht qa q i dëmshëm, kom ni që ta bojn sheqerin, nkrejt portalet e ki qashtu*

- Recetat e gatimit të mësuara nga interneti: *llazanien për herë tparë e kom lexu qysh marohet te qajo faqja që ma tregove, po mujshe me maru pite pa yndyrë, qe ta dërgoj linkun*

Siç e shohim, krahas problemeve personale, këto ngjarje të shpërndara botërisht janë opsioni i parë si material për biseda të përditshme, për shkak se shquhen për karakter ndërkombëtar.

8. Përfundimi

Studimi tregon se të rejat, gjatë ekspozimit ndaj gjërave, situatave e koncepteve të reja të teknologjisë, nuk rreshtin kurrë së sjelli risi kuptimore e leksikore. Globalizimi e ka shkaktuar, ndër të tjera, vetëdijesimin e tyre për lirinë që u takon në aspektin shprehës e komunikues, duke u mundësuar qasje në shumë materiale që lidhen me (mos)shkeljen e të drejtave pa asnjë arsye të mirëqenë dhe nevojës për ta ngritur zërin sa herë që ndodh diçka e tillë. Ai gjithashtu e ka zgjeruar repertorin e temave, perspektivave të shprehshme edhe nga ato. Këtë nuk e bëjnë thjesht duke krijuar neologjizma.

Vajzat e reja në këtë studim i shfrytëzojnë resurset fjalëformuese për ta kapur nuancën që duan ta arrijnë, duke ndjekur kriteret e paracaktuara në mendjen e tyre për gjuhën shqipe, p.sh. me -shme, -tor, ueshëm. Emrat konkretë, mbiemrat cilësorë, foljet kalimtare janë karakteristikë e shpesh të vërejtur gjatë diskutimit të temave të përditshme, që dëshmon për natyrën e drejtpërdrejtë e njëkohësisht të butë të tyre. Gjithashtu s'kursen temat e karrierës, që janë shmangur në kohë të dikurshme. S'është rastësi që tematikat mbizotëruese lidhen me ngjarjet botërore më të spikatura. Ky është rezultat i shpenzimit të kohës më të madhe në rrjete sociale, në kontakt e udhëtime në vende të shumta të botës.

Ato e ruajnë gjuhën tipike të vajzave që dëshmohet në studime botërore, veçse e pasurojnë atë me fjalë të pazakonshme për to, që flet për guximin e shtuar, mendjehapësinë që tani janë duke e konsoliduar. Sado e fortë të jetë rezistenca e gjinisë së kundërt për ta ruajtur "modelin e ngulitur" konvencional se djemtë janë sundimtarë, ato po tregohen qëndrestare të forta edhe në gjuhë me pasurinë e fjalorit mendor, të cilin s'mund t'ia vjedhë askush. Siç është shprehur autori roman, Ciceroni: *memoria është shtëpi-thesar i të gjitha gjërave*".

Referencat

- [1]. Albrow, M .2000. *The Golden Age: State and Society Beyond Modernity*. Stanford, CA: Stanford University Press
- [2]. Chomsky, N 1981. *Lectures on government and binding*. Dordrecht: Foris.
- [3]. Coulmas, Florian. 2005. Changing language regimes in globalizing environments. *International Journal of the Sociology of Language* 175/176.3-15
- [4]. Crawford, M. 1995. *Talking Difference on Gender and Language*, London: Sage Publications.
- [5]. Cuellar, S. B. 2006. *Women's language: a struggle to overcome inequality*. Colombia: Universidad Nacional de Colombia.
- [6]. Halliday M.A.K., Yallop Colin. 2007. *Lexicology: A Short Introduction*. London: Continuum.
- [7]. Harris, R. L. 2002. Introduction: Globalization and Globalism in Latin America: Contending Perspectives. *Latin American Perspectives*, 29(6), 5-23.
- [8]. Holmes, J. 1995. *Women, Men and Politeness*. London: Longman.
- [9]. Huddleston, R. 1984. *Introduction to the grammar of English*. Cambridge: Cambridge University Press.
- [10]. Lakoff, R. 1973. *Language and Woman's Place* :Language in Society, Vol. 2, No. 1, pp. 45-80: Cambridge University Press.
- [11]. Martinet A.2002 *Elemente të gjuhësisë së përgjithshme*. Përkth. Rexhep Ismajli.Tiranë: Dituria.
- [12]. Saussure, F. de. , 1977. *Kursi i Gjuhësisë së Përgjithshme*, Përkth. Rexhep Ismajli. Prishtinë: Rilindja, Redaksia e Botimeve.
- [13]. Saussure, F. de. 1983 *Course in General Linguistics*. London, Duckëorth.
- [14]. Tannen, D. 1990,*You Just Don't Understand: Women and Men in Conversation*: Ballantine books.
- [15]. Tannen, D. 1996, *Gender and Discourse* Oxford:Oxford University Press.
- [16]. Thomai, J. 1999. *Leksikologjia e gjuhës shqipe*. Tiranë: SHBLU.
- [17]. Thomai, J. 2009. *Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe*. Tiranë: Botimet EDFA.
- [18]. Wahyuningsih, S. 2018. *Men and women differences in using language: a case study of students at Stain kodus*. *EduLite Journal of English Education Literature and Culture* 3(1):79
- [19]. Waterman, P. 2002 '*Reflections on the 2nd World Social Forum in Porto Alegre: What's Left Internationally?*' Working Papers Series, no 362, The Hague: Institute of Social Studies.